

PROJEKTI MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIMIT  
DHE PUNËSIMIT NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE SERBI

STRATEGJIA PËR RRITJEN E BASHKËPUNIMIT  
GJITHPËRFSHIRJEN DHE ZHVILLIMIN E SHKOLLAVE  
TË MESME PROFESIONALE DEGA  
HOTELIERI-TURIZËM  
NË KOMUNAT: PEJË, GJAKOVË DHE PRIZREN

Pejë, Tetor 2015



Mbështetja e përgatitjes dhe publikimit:

Programi SEED Kosovë

Financuar nga:

Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA)

Konsulent dhe autor:

Dritan Shala, M.Sc

© Tetor 2015, OJQ Syri i Vizionit, Pejë

Përkthyer në serbisht dhe anglisht, versioni burimor është versioni në shqip

*Falënderim i veçantë për të gjithë anëtarët dhe Këshillat Komunale*

*për kontributin e rëndësishëm të pakursyer*

*në procesin e konsultimeve dhe hartimit të kësaj strategjie*

*si dhe donatorin pa ndihmën gjeneroze të cilit ky proces nuk do të ishte i mundur!*

### **Pjesëmarrësit në Këshillin Komunal (grupin punues) në Pejë:**

Besim Avdimetaj – Drejtoria e Arsimit Pejë; Artan Gashi – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Pejë; Sami Gashi – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Pejë; Ali Dresha – Zyra e Turizmit Pejë; Samir Lleshi – Oda Ekonomike; Leman Hatashi – RDA West; Ramë Mujaj – Restorant Relax; Egzon Qorkadiu – Porta Perëndimore; Sali Maloku – Shoqata e bleshkatarëve “Gjeravica”; Agon Hoxha – Sh.M.E “Ali Hadri”; Teuta Kryeziu - Sh.M.E “Ali Hadri”; Mustaf Camaj - Sh.M.E “Ali Hadri”; Erdin Gashi – Nxënës; Leutrim Selimaj – Nxënës; Egzon Demalijaj – Nxënës; Arlind Zuma – Nxënës; Gentrit Camaj – Nxënës; Shkelzen Rexhaj – Nxënës; Fidan Kastrati – Nxënës; Semsije Seferi – OJQ Alma; Shasimete Selimaj – OJQ 7 Shtatori; Ismet Shala – Shoqata e Hoteleve dhe Artizanaleve; Agim Kelmendi – Shoqata e Zejtareve; Nol Krasniqi – Marimangat e Pejës; Syzane Baja – Solidar Suisse; Arbërorë Haxhija – ARDA West; Arbnor Lleshi – OJQ Porta Perëndimore; Feim Kollçaku – S.Sh Pro Ski; Agron Nikqi – Restorant Bleshka; Agron Kaliqani – Rugova Experience; Kreshnik Potoqani – ERA Group; Haki Lekaj – Marimangat e Pejës; Dude Avdyli – OJQ 7 Shtatori; Toska Zeneli – RDA West; Sokol Luta – RDA West; Drenushe Gaxherri – Univerziteti “Haxhi Zeka”; Gramen Tarku – DMO West; Ylber Rudi – Hotel Rudi;

### **Pjesëmarrësit në Këshillin Komunal (grupin punues) në Gjakovë:**

Diana Qarkaxhia – Drejtoria e Arsimit Gjakovë, Silvana Domi – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Gjakovë; Arber Gola – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Gjakovë; Dardan Bakija – Drejtoria e Arsimit Gjakovë; Nexhmedin Varaku – Drejtoria e Arsimit Gjakovë; Veli Bakija – Zyra e Turizmit Gjakovë; Lulzim Jupa – K.K Gjakovë; Ali Shehu – Sh.M.E “Kadri Kusari”; Arben Sufaj – Sh.M.E “Kadri Kusari”; Armend Gjoshi – Armend Tours; Drenusha Mula – OJQ Qabrati; Skender Sina – Sh.B.A “Pashtriku”; Ali Haraqija – Shoqata Zejtare “Çarshia Madhe”; Flamur Gola – Restorant “Ura”; Kujtim Rahmani – Arteza; Vegim Hoxha – Arteza; Eranda Baçi – OJQ IFK; Qëndresa Kadriqeli – OJQ Medica Kosova; Kosovare Sahatqija – OJQ SHE-ERA; Shkelqim Jupa – Hotel “Çarshia e Jupave”; Jona Komoni – Nxënëse; Eli Bytyqi – Nxënëse; Erlis Morina – Nxënës; Lirim Nivokazi – Nxënës; Liridon Sejdaç – Nxënës; Labinot Pnishi – Nxënës; Fatos Haraçia – Restonat “Hani i Haraçisë”; Lulzim Radoniqi – Hotelier; Shqipe Mula – OJQ Qabrati; Shkelzen Rexha – OJQ ProCult; Freskina Mula – OJQ IFK; Rron Jupa – Hotel “Çarshia e Jupave”; Berat Thaqi – B.C.S Gjakovë; Nexhat Dula – Sh.B.A “Pashtriku”;

### **Pjesëmarrësit në Këshillin Komunal (grupin punues) në Prizren:**

Mensur Bytyqi – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit Prizren; Sherife Gengaj – Drejtoria e Turizmit; Hasime Rashkaj – Drejtoria e Turizmit; Alida Miftari – Zyra për Barazi Gjinore Prizren; Myvedete Gavazaj – Sh.M.E “Ymer Prizreni”; Arife Muji – Sh.M.E “Ymer Prizreni”; Nuredin Halili – Sh.M.E “Ymer Prizreni”; Admir Rama – Sh.M.E “Ymer Prizreni”; Latif Berisha – Sh.M.E “Ymer Prizreni”; Naim Cahani – KDI; Besnik Dullaj – Sh.B “SHARRI”, Visar Kolshi – Shoqata Esnaf; Rafet Bushati – Sh.Z.A.P; Vetim Krasniqi – OJQ “Ec Ma Ndryshe”; Bekim Bytyqi – P.K “Sharri”; Medisa Sagdati – ATRJK Prizren; Hajrulla Çeku – Ec Ma Ndryshe; Valdete Daka – Hotel Alvida; Vildan Luma – ASB Prizren; Afrim Tejeci – SHZAP; Arlinda Osmanaj – Nxënëse; Gjylsime Seferaj – Nxënëse; Hatmane Krasniqi – Nxënëse; Alba Hajdari – Nxënëse; Shelbrim Qunaj – Nxënës; Armir Osamni – Nxënës; Shqipron Muharremi – Nxënës; Dashurije Sahiti OJQ “Sara”; Krenar Krajku – Restorant Ambient; Elmedina Baxhaku – Ec Ma Ndryshe; Erim Berisha – Esnaf; Doruntina Ukimeri – Dokufest; Kushtrim Hasani – Pasticeria “SanRemo”; Sadik Shporta – Sh.B “Sharri”; Haxhi Seferaj – KDI; Flaka Bytyqi – Agjensioni Sharri Outdoor; Recep Lisiça – Shoqata Esnaf;

## Përmbajtja

Përmbledhje .....	07
Konteksti .....	08
Historik i shkurtër i SHME dega Hotelieri Turizëm në zonën e përfshirë .....	09
Gjendja dhe sfidat e arsimit profesional – Hotelieri Turizëm në Zonën e Përfshirë .....	12
Metodologjia dhe Procesi i Zhvillimit të Strategjisë .....	15
Konsultimet .....	17
Objektivat dhe masat .....	22
Realizimi i Strategjisë .....	23
Referencat .....	24
Korniza Logjike (masat).....	25



Strategjia për rritjen e bashkëpunimit, gjithpërfshirjen dhe zhvillimin e shkollave të mesme profesionale dega Hotelieri-Turizëm (HT) në Komunat Pejë, Gjakovë dhe Prizren është orientuar në aspektet e rritjes së bashkëpunimit të shkollave të mesme profesionale me bizneset HT dhe palët tjera të interesuara në zonën e përfshirë; gjithpërfshirjen në kuptimin rritjes së pjesëmarrjes kualitative të kandidatëve veçanërisht rritjen e pjesëmarrjes së femrave kandidate për studime në këto shkolla dhe si punonjëse në industri, si dhe; zhvillimin e këtyre shkollave në kuptimin e përshtatjes së plan-programeve në bazë nevojave të tregut, zhvillimin e praktikave profesionale cilësore si dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore, infrastrukurore dhe financiare të personelit për rritjen - menaxhim e cilësisë.

Strategjia për ndërhyrje është hartuar në bazë të një sërë takimesh punuese të Komisioneve Komunale (Lokal) si grupe ndër-sektoriale punuese të krijuara nga bartësi i Strategjisë (OJQ Syri i Vizionit) përbërë nga përfaqësues të shkollave të mesme profesionale dhe biznese HT në Pejë, Gjakovë dhe Prizren, si dhe nga Komunat dhe shoqëria civile. Takimet janë realizuar në këto komuna gjatë vitit 2014 - 2015 me mbështetje nga konsulenti i angazhuar në kuadër të programit SEED. Pjesë integrale e procesit të planifikimit ishin edhe hulumtimi i gjendjes dhe konsultimi i kornizës ligjore dhe dokumenteve teknike si strategji dhe raporte kombëtare, rajonale/lokale si dhe një vizitë studimore e realizuar në Austri shkollave profesionale për të parë formën e organizimit të procesit mësimor, praktikat profesionale dhe kooperimit të palëve të interesit si institucionet dhe bizneset e sektorit HT.

Palët e përfshira (Komisionet Komunale) aprovuan Strategjinë dhe janë të vendosur për implementimin dhe promovimin e saj përmes një konference, faqes së internetit të bartësit të Strategjisë dhe forma tjera prezantimi. Strategjia përbëhet nga 4 objektiva të përgjithshëm, ashtu siç janë konceptualizuar dhe miratuar nga Këshillat Komunale ndarazi, më pastaj integruar në këtë dokument:

- Krijimi i një sistemi për të përditësuar plan programet e shkollave të mesme profesionale dega hotelieri turizëm (HT) në zonën e përfshirë sipas nevojave të tregut
- Krijimi i një sistemi efektiv të praktikave profesionale që nxënësit e shkollave të mesme profesionale HT në zonën e përfshirë të pajisen me shkathtësi praktike
- Krijimi i një sistemi për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të shkollave të mesme profesionale HT në zonën e përfshirë lidhur me nevojat dhe mjedisin e biznesit HT
- Rritja e numrit të femrave në sektorin hotelieri turizëm në zonën e përfshirë

Çdo objektivë përmban në vete një numër (14) objektivash specifik dhe një sërë masash (52) të parapara për arritjen e atyre objektivave si në vete dhe/apo të ndërlydhura me objektiva apo masa tjera.

Andaj, të gjitha këto, dhe jo vetëm, kanë bërë që të ndërmerren veprime përmes projektit SEED i cili rezultoi në këtë Strategji. Ndonëse gjatë procesit zhvillimor të strategjisë një numër palësh të interesuara janë identifikuar, strategjia intervenuese nuk specifikon përgjegjësit dhe buxhetin për implementim. Kjo i është lënë zgjidhjeve konkurruese që priten të propozohen dhe realizohen nga palët e interesuara bazuar në një thirrje për projekt propozime që pritet të financohen nga një skemë e granteve të vogla që është zhvilluar dhe do të realizohet si pjesë e programit SEED në Kosovë. Përveç kësaj, strategjia do t'iu shërbej gjithë palëve të interesuara duke përfshi institucionet lokale dhe qendrore dhe donatorët të cilët mund dhe inkurajohen të ndërmarrin aktivitete dhe konsiderojnë atë në planifikim dhe zhvillime tjera.

Ne vijim është paraqitur një përmbledhje rreth kontekstit, gjendja dhe sfidat, metodologjia e përdorur, konsultimet, hulumtimi, objektivat, masat dhe aspekte realizimi.



## KONTEKSTI

Programi SEED është program trevjeçar që ka filluar në Janar të 2014 dhe është i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe realizohet në tri shtete në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi. Programi ka për qëllim që të përmirësojë qasjen e të rinjve dhe femrave në tregun e punës si dhe të kontribuojë në barazinë gjinore duke mbështetur zhvillimet pozitive sociale-ekonomike.

Në Kosovë programi realizohet nga organizata jo qeveritare (OJQ) “Syri i Vizionit” dhe përqendrohet në ngritjen e bashkëpunimit në mes shkollave të mesme profesionale drejtimi i Turizmit dhe Hotelerisë (HT) në Pejë, Gjakovë dhe Prizren me bizneset aktive të këtij sektori dhe hisedarët tjerë në të tre komunat, referuar si zona e përfshirë në këtë projekt.

Aftësimi Profesional në Kosovë është pjesë e shkollimit të mesëm, dhe i shërben grup moshave 15 – 18 vjeçare, që funksionojnë nën përgjegjësin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) si dhe Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA). Shkollat në të cilat është koncentruar programi SEED janë Shkolla e Mesme Ekonomike të cilat kanë drejtimin e Hotelerisë dhe Turizmit në Pejë, Gjakovë dhe Prizren të cilat së bashku numërojnë rreth 300 nxënës nga të cilët vetëm 5 femra.



# HISTORIK I SHKURTËR I SHME DEGA HOTELIERI TURIZËM NË ZONËN E PËRFSHIRË

## Shkolla e Mesme Ekonomike "ALI HADRI" në Pejë

Shkolla e Mesme Ekonomike "Ali Hadri" në Pejë u themelua që në vitin 1946 me emrin Akademia Tregtare Shtetërore në ish-ndërtesën e Gjimnazit fillimisht me dy klasë me gjithsejtë 95 nxënës. Me kohë shkolla u rrit me nxënës dhe personel arsimor dhe kaloi në ndërtesën e ish-kazermave ushtarake të vjetra dhe qëndroi deri në vitin 1972 kur u themelua Qendra Ekonomike e cila në kuadrin e vet përfshinte edhe shkollën bujqësore dhe shkollën tregtare. Kjo Qendër kaloi në ndërtesën e shkollës bujqësore, e cila ishte ngritur në vitin 1961 ku ndodhet edhe sot, me objekte të renovuara dhe pajisura.



Sot, mësimi në shkollë zhvillohet në dy gjuhë zyrtare në Pejë me 51 paralele në gjuhën shqipe dhe 7 në gjuhën boshnjake. Në vitin shkollor 2015/16 mësimin e ndjekin 1067 nxënës në drejtime të ndryshme. Shkolla ka këto drejtime: Hoteleri dhe Turizëm me profilet: Asistent dhe Teknik Hoteli, Teknik Turizmi, Asistent Restoranti, Gjellëbërës dhe Pastiçer. Drejtimet tjera janë: Administrim Biznesi, Ekonomi me profilet: Kontabilitet, Banka dhe Sigurime, Logjistikë, Shpedicion, Tregti me Shumicë dhe Pakicë; drejtimi Asistent Administrate me profilet: Asistent Juridik dhe Asistent i Administratës; Teknologji e Ushqimit; Pylltari me profilin Teknik i Pylltarisë; Veterinari me profil Teknik i Veterinarisë si dhe drejtimi Bujqësi me profilin Hortikulturë. Kjo shkollë kishte një profil në rrjetin social face book me një fotografi të personelit para shkollës, tabelen e emërimit dhe logon, disa kategori informatash dhe arkiv fotografish nga aktivitete mësimore dhe argëtuese, përfshirë disa lista nxënësish. Në kategorinë "About" ishte paraqitur misioni i shkollës: "Edukimi dhe arsimimi i brezave të rinj në mënyrë që në të ardhmen e afërt të përgatiten për sfidat e jetës, tregun e punës dhe kështu të kontribuojnë në zhvillimin e familjes dhe shoqërisë" pa ndonjë informatë të shkurtë rreth kësaj shkolle dhe drejtimit HT.

## Shkolla e Mesme Ekonomike "KADRI KUSARI" në Gjakovë

Shkolla e mesme ekonomike "Kadri Kusari" në Gjakovë ka filluar të funksionoj si shkollë e pavarur në vitin 1960. Shkolla sot është një shkollë e mesme bashkëkohore e profilit ekonomik. Mësimin në këtë institucion gjatë vitit shkollor 2015/2016 e ndjekin 910 nxënës, në drejtimet dhe profilet vijuese: Drejtimi Hoteleri me profilet: Asistent Hoteli, Gjellëbërës dhe Asistent Turistik aktualisht 74 nxënës.

Drejtimet tjera në këtë shkollë janë Ekonomi me profilet: Kontabilitet, Financa, Banka, Sigurime, Shpediton dhe Logjistikë me 504 nxënës; drejtimi Juridik me profilet: Asistent Juridik dhe Asistent Administrate me 257 nxënës; si dhe drejtimi Bujqësi me profilet: Agrobiznes, Pemëtari dhe Vreshtari, Veterinari dhe Teknologji Ushqimore me 74 nxënës. Kjo shkollë kishte një profil në face book me një pamje te objektit, logon dhe udheheqjen e shkollës dhe fotografi nga ndonjë aktivitet edukativo rekreativ, pa ndonjë informatë të shkurtë rreth kësaj shkolle dhe drejtimit HT.

SHME: "KADRI KUSARI"

SHME "Kadri Kusari" Gjakovë  
School

Timeline About Photos Reviews More

About SHME "Kadri Kusari" Gjakovë

Overview  
Page Info

SHME "Kadri Kusari" Gjakovë - Faqja Zyrtare

"Normatja e Gjakovës" ...  
Gjakova

0390

Ask for SHME "Kadri Kusari" Gjakovë's website

## Shkolla e Mesme Ekonomike "YMER PRIZRENI" në Prizren



Shkolla e Mesme Ekonomike "Ymer Prizreni" në Prizren është themeluar në vitin 1945 si Shkollë e Mësuesisë në Prishtinë, e cila më vonë prej tetorit 1948 u transferua në Prizren. Prej vitit 1956 kjo shkollë mësimet i vijoj në ndërtesën e kishës, në gjuhën shqipe, ndërsa më vonë edhe në gjuhën turke. Më vitin 1974 shkolla u transformua në "Shkollë pedagogjike", në periudhën 1978-1986 punoi si shkollë e mesme "Mësimi të Orientuar", kurse në vitin 1986 shkolla transformohet në "Shkollë Profesionale" me drejtimet në Ekonomi, Bujqësi dhe Tregti. Dikur ky institucion edukativo-arsimor ishte shkollë normale në Prizren, por pastaj me reformën e arsimit në vitin 1978/80 u formua si qendër shkollore për fazën e parë të bazave të përgjithshme, ku nxënësit mësonin klasën e parë dhe dytë. Pas kësaj ata orientoheshin për fazën e dytë në qendra tjera shkollore, si në degët e ekonomisë, tregtisë dhe bujqësisë. Dega Bujqësi funksioni deri në vitin shkollor 1990/91 kur në vend të saj u formua dega e Hotelerisë.

Nga shtatori i vitit 2010 Shkolla e Mesme Ekonomike "Ymer Prizreni" ka objektin e ri të shkollës në lagjen "Bajram Curri" në Prizren. Në vitin akademik 2015/2016 në këtë shkollë mësimin e vijnë 1668 nxënës në drejtimet: Hoteleri dhe Turizëm, Ekonomi, Administrim Biznesi, Juridik, Tregti dhe Teknologji ushqimore me profilet e ndara.

Edhe kjo shkollë kishte vetëm një prezantim në rrjetin social face book, sic është treguar më lartë, pa ndonjë logo, ndërsa pamja e objektit është marrë nga galleria e kësaj faqe. Tek pjesa e informatave rreth kësaj shkolle "About" kishte një organizim kategorish me informata por asnjë kategori nuk ishte funksionale, duket në process përgatitje. Të tre shkollat nuk kanë faqe internet të tyre.

## **GJENDJA DHE SFIDAT E ARSIMIT PROFESIONAL - HOTELIERI TURIZËM NË ZONËN E PËRFSHIRË**

Si në çdo sferë të arsimit, praktika profesionale e nxënësve të SHME dega Hotelieri Turizëm në Pejë, Gjakovë dhe Prizren është kompletim i teorisë së mësuar në shkollë dhe një domosdoshmëri e vlerësuar nga të gjithë palët e interesuara. Praktika profesionale është e paraparë në plan-programin e kësaj dege, sipas përcaktimit të MASHT-it, potencuar në Strategjinë për Arsimin e Mesëm Profesional të kësaj ministrie, potencuar ndër tjera edhe në Strategjisë për Zhvillimin e Komunës së Pejës 2013 – 2017 si dhe në Strategjinë e Turizmit për Rajonin Ekonomik Perëndimor dhe atë Jugor (pjesa e ngritjes së kapaciteteve njerëzore, etj.).

Aktualisht, praktika e nxënësve të këtij drejtimi bëhet nëpër klasa të improvizuara të këtyre shkollave, dhe ndonjë vizitë e nxënësve nëpër biznese organizuar në mënyrë vetanake së shumti. Mundësia që nxënësit të kryejnë praktikë më varet prej punës së personelit të këtyre shkollave. Mungon bashkëpunimi i institucionalizuar i shkollës me ndërmarrjet. Nxënësit të cilët kanë siguruar mundësi praktike dhe/apo pune, zakonisht punojnë si kamerier e jo ndonjë profil tjetër ndonëse ata kanë nevojë praktike më të zgjeruar në formë, përmbajtje dhe kohë.

Kandidatët që aplikojnë për të ndjekur shkollimin e mesëm profesional në drejtimin hotelieri turizëm janë të cilësuar nga profesorët dhe menaxhmenti i këtyre shkollave si nxënës jo të mirë, arsyeja është tradita e të menduarit tek prindërit dhe qytetarët në përgjithësi se në këto shkolla shkojnë vetëm nxënës jo të mirë, ndërsa të mirët ndjekin mësimet në Gjimnaz e ngjashëm. Ndërsa mungesa e femrave në shkollat dhe sektorin HT është rezultat mos informimi mbi modulet që mësohen në këtë drejtim, profile i turizmit dhe hotelieri është duke u asociuar me kamerier, që është duke ndikuar në mos interesimin e femrave në këtë sektor. Syri i Vizionit në kuadër të projektit SEED ka bërë publikimin e raportit të studimit për barrierat e pjesëmarrjes së femrave në sektorin e turizmit dhe hotelierisë.

Ndërmarrjet janë të pa informuara mbi plan programin e shkollës, dhe shkolla nuk posedon mekanizma për matjen e nevojave të tregut si dhe mungon kapacitet në shkolla për matjen dhe vendosjen e nevojave të tregut në plan programe. Nxënësit të cilët në formë vetanake kanë gjetur punë dhe ndjekin drejtimin e hotelierisë dhe turizmit punojnë si kamerier derisa nuk ndjekin module tjera të paraparë për te fituar praktikë gjatë përfundimit të shkollimit (p.sh.. kuzhinier, agjension turistike, pastiqeri, asistent menaxheri të hotelit, administratë e hotelit etj.).

Nxënësit nuk mund të aftësohen dhe të përgatiten sipas nevojave të tregut të punës nëse nuk ka bashkëpunim mes shkollave profesionale dhe ndërmarrjeve të sektorit të hotelierisë dhe turizmit. Për të kuptuar gjendjen më për së afërmi, në kuadër të programit dhe të tjera janë realizuar dy hulumtime që paraqesin gjendjen, sfidat, mundësitë dhe rekomandime për SHME drejtimi Hotelieri dhe Turizëm në zonën e përfshirë, veçanërisht lidhur me praktikat profesionale dhe pjesëmarrjen e femrës:

- Hulumtimi i nevojave dhe mundësive të sektorit hotelieri turizëm për Praktikant Profesional të nxënësve të degës Hotelieri Turizëm të SHME “Ali Hadri” në Pejë në kuadër të projektit “Mismatch” (Dhjetor 2013), si dhe
- hulumtimi për barrierat gjinore që lidhen me pjesëmarrjen e femrave në edukim e punësim në sektorin e turizmit në Kosovë në kuadër të Programit SEED (Janar 2015) si dhe është organizuar një trajnim për çështje gjinore me ekspert për këshillat komunale.

Andaj, të gjitha këto, dhe jo vetëm, kanë bërë që të ndërmerren veprime përmes projektit SEED i cili rezultoi në këtë Strategji për ndërhyrje e paraqitur në vijim me një përmbledhje rreth procesit të zhvillimit, metodologjia (duke përfshi konsultimet, hulumtimin dhe literaturën, një vizitë studimore), objektivat dhe masat e propozuara, si dhe aspekte realizimi të Strategjisë.

Këshillat komunale të hisedarëve kanë konstatuar që mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit mes hisedarëve të sektorit të hotelerisë dhe turizmit kanë sjellë një numër sfidash. Në vijim është një përmbledhje e sfidave të identifikuara nga hisedarët në këtë proces konsultimesh dhe planifikimi strategjik.


- Plan-programi i pa përditësuar: Plan programi i shkollave të mesme profesionale dega HT në zonën e përfshirë duhet të pasurohet dhe përshtatet nevojave të sektorit HT, duke përfshirë shtimin e profileve/moduleve të reja si dhe ngritjen e aftësive të nxënësve në kuptim të përgjithshëm ndër-sektorial si shkathtësi komunikimi, gjuhë të huaja, përdorim TI, planifikim, ndërmarrësi, etj.
- Mungesa e praktikës profesionale: Praktikantët e nxënësve në bizneset HT në zonën e përfshirë vlerësohen si të kufizuara dhe të pamjaftueshme në kuptim sasior dhe cilësor, ndonëse ato janë të parapara me plan program dhe të detyrueshme, por mungon një sistem funksionimi përkundër disa nismave.
- Personeli mësimdhënës: Personeli mësimdhënës në shkollat e mesme dega HT ka nevojë për mbështetje për të arsimuar të rinjtë në këtë sektor. Ata kanë nevojë për bashkëpunim dhe mbështetje nga biznesi HT, institucionet relevante dhe hisedarët tjerë.



- Mungesa e bashkëpunimit: Ka mungesë të bashkëpunimit në mes të biznesit dhe drejtimit të turizmit e hotelerisë të shkollave të mesmeve profesionale si dhe institucioneve komunale në zonën e përfshirë.
- Barrierat kulturore: Ka vështirësi në përfshirjen e femrave në sektorin e turizmit dhe hotelerisë, si në arsim ashtu edhe në bizneset e këtij sektori për arsye të shumta kulturore të trashëguara dhe të reja sidomos rreth ndarjes së roleve dhe profesionet e gjinive të ndryshme.

# METODOLOGJIA DHE PROCESI I ZHVILLIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia për rritjen e bashkëpunimit, gjithë përfshirjen dhe zhvillimin e shkollave të mesme profesionale dega Hotelieri-Turizëm në Komunitet Pejë, Gjakovë dhe Prizren është hartuar në bazë të një sërë takimesh punuese të Komisioneve Komunale (Lokal) si grupe ndër-sektoriale të përbëra nga përfaqësues të shkollave të mesme hotelieri turizëm në Pejë, Gjakovë dhe Prizren të realizuara në këto komuna me mbështetje nga konsulentët i angazhuar në kuadër të programit SEED që hartoi Strategjinë. Pjesë integrale e procesit të planifikimit ishin hulumtimi i gjendjes, konsultimet, shqyrtimi i kornizës ligjore dhe dokumenteve si strategji dhe raporte kombëtare, rajonale/lokale si dhe një vizitë studimore në Austri.



## Hulumtimi gjendjes dhe nevojave:

- Raporti: Hulumtimi i nevojave dhe mundësive të sektorit hotelieri turizëm për Praktikant Profesionale të nxënësve të degës Hotelieri Turizëm të SHME “Ali Hadri” në Pejë;
- Hulumtimi për barrierat gjinore që lidhen me pjesëmarrjen e femrave në edukim e punësim në sektorin e turizmit në Kosovë në kuadër të Programit SEED;

## Korniza e legjislative sektoriale:

- Ligji Nr. 04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë;
- Ligje tjera ndërlidhur me tematikën Hotelieri Turizëm, si Ligji për Turizmin, ai për Punësim, etj.

## Strategjitë ekzistuese sektoriale:

- Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë 2013-2020;
- Strategjitë për zhvillimin rajonal ekonomik të rajonit jugor dhe perëndimor 2010 – 2013 dhe strategjitë sektoriale të turizmit që kanë derivuar nga strategjitë e përgjithshme;
- Strategjia rajonale për turizëm të qëndrueshëm në rajonin perëndimor të Kosovës (2013);
- Strategjia për zhvillimin ekonomik në Komunën e Pejës 2013 – 2017.

## Vizita studimore e hisedarëve në Austri

Vizita studimore në Vjenë, Austri me grupin përfitues të programit SEED në Kosovë u realizua nga 15 deri 19 Qershori 2015. Në këtë vizitë morën pjesë 12 pjesëmarrës - 3 përfaqësues nga secila komunë (Pejë, Gjakovë dhe Prizren) me përbërje të një përfaqësuesi nga bizneset HT, një nga Komunitatet, një nga shkollat HT si dhe personel të programit SEED. Gjatë kësaj kohe pjesëmarrësit kanë vizituar shkollat profesionale HT ku janë informuar rreth tërheqjes e kandidatëve për studime, procesin e mësimin profesional dhe marrëdhëniet që shkollat kanë me bizneset HT dhe institucionet qeverisëse.

Pjesë e vizitës ishte Parlamenti Austriak, qendrat e arsimit profesional, Oda Ekonomike Austriake, Qendra e Punësimit, etj. ku observuan së afërmi në veçanti se si funksionon procesi mësimor dhe praktika profesionale në Bizneset HT si dhe kooperimin e këtyre shkollave me bizneset dhe palët e tjera.




Në fillim të programit, OJQ Syri i Vizionit ka krijuar këshillat lokal (grup punues) të palëve të përfshira (apo hisedarët) në komunat e përfshira në projekt Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Të tre këshillat përbëheshin nga përfaqësues të shkollave të mesme profesionale drejtimi i Hoteleri Turizëm (menaxhmenti, disa mësimdhënës dhe nxënës) në secilën nga komunat e lartë përmendura, bizneset HT lokale, institucionet komunale si sektorët për arsim, zhvillim dhe turizëm si dhe shoqëria civile. Janë zhvilluar konsultime përmes një seri punëtorish e konsultimesh me pjesëmarrje të anëtarëve të këshillit lokal të secilës komunë paralelisht me organizim të implementuesit të programit SEED. Kontributet janë gjeneruar dhe konsoliduar hap pas hapi bazuar në udhëzuesin e Komisionit European për menaxhimin e ciklit të projekteve ku pjesëmarrësit kanë punuar në mënyrë individuale dhe ekipore të orientuar në disa grupe të vogla tematike në bazë të problematikave të identifikuar që në fillim. Si rezultat i këtyre takimeve punuese është krijuar përmbajtja e strategjisë së intervenimeve për bashkëpunim, gjithëpërfshirje dhe zhvillim të shkollave dhe sektorit HT në zonën e përfshirë.

Zhvillimi dhe hartimi i Strategjisë është asistuar dhe hartuar nga konsulenti në zhvillim lokal Dritan Shala M.S.c - kompania konsulente HROD e cila është angazhuar nga bartësi i strategjisë në kuadër të implementimit të programit SEED si kuadër me kapacitet të treguar në planifikim strategjik dhe ngritje kapacitetesh përfshirë sektorin HT.

Në vijim është përmbledhja e fazave të zhvillimit konceptualizimit të strategjisë në 4 takime punuese të Këshillit lokal në Pejë, Gjakovë dhe Prizren, mbajtur përgjatë periudhës së konsultimeve 2014 - 2015 dhe aspektet e trajtuara si

analiza e situatës, krijimi i vizionit, identifikimi dhe përzgjedhja e masave dhe hartimi i kësaj strategjie intervenuese.



**Punëtorja 1** –mbajtur me 25 qershor 2014 ka mundur një vetëvlerësim, në mënyrë të pa varur nga pjesëmarrësve, lidhur me disa supozime të parapërgatitura në formë pyetësori me 15 pjesë për nivelin e lidhshmërisë së shkollimit të mesëm profesional dega HT dhe shkathtësive të nevojshme për tregun. Në bazë të reagimeve në pyetësor është bërë i mundur identifikimi i hershëm i gjendjen e programeve dhe praktikave të këtyre shkollave në raport me nevojat e tregut.

Në këtë punëtori u identifikuan avantazhet dhe të metat/sfidat në orientimin e këtyre shkollave kundrejt kërkesave të tregut. Rezultatet ndryshojnë por në përgjithësi gjendja është e njëjtë me disa ndryshime ku psh. ekzistenca e zyrës së turizmit në Pejë shihet si avantazh që për të dy



*Pamje ilustruese nga punëtorja e parë në Prizren*

komunat tjera është e metë, apo organizimi i shoqatës së bizneseve zejtare e afariste në Prizren e asaj zejtarëve në Gjakovë e Pejë paraqesin një mundësi por edhe të metë në kuptim të funksionalitetit të tyre, derisa në tërë rajonin mungon organizimi i një shoqate profesionale të bizneseve hoteliere turistike e cila do të përcjelle zhvillimet dhe identifikimin e kërkesave të tregut dhe do të ishte mbështetje për ngritjen e kualitetit të shkollave dhe sektorit HT.

Sa i përket analizës lidhur me gjendjen në shkollimin e mesëm profesional HT në zonën e përfshirë, nga vlerësimet e këshillave lokale rezultojnë se plan programet shkollore janë të vjetruara dhe pa adaptuar kërkesave të tregut për profile të reja si udhëzues dhe ciceron kulturor dhe natyror, animator, etj. apo e disa lëndëve/profileve që ekzistojnë në një shkollë si psh. disa profile hoteliere që janë në Pejë nuk ekzistojnë në shkollën e mesme në Gjakovë; pastaj mungesa e praktikës profesionale kualitative, mungesa apo pamjaftueshmëria e personelit profesional, mungesa e bashkëpunimit dhe mospjesëmarrja apo pjesëmarrja kritike e ulët e femrave në shkollimin e mesëm profesional dega HT dhe po ashtu edhe në bizneset në zonën e përfshirë, ndonëse në biznese ka pak ndryshim.

Sipas gjendjes së tanishme, nga rreth 300 nxënës që aktualisht kanë së bashku të tri shkollat e mesme profesionale HT në zonën e përfshirë, vetëm 5 prej tyre janë femra (1.6%). Sido që të jetë, arsyet janë së shumti bazuar në kulturën e përgjithshme dhe lokalitetin tradicional, ndonëse i konsideruar i tejkaluar supozimi se femrat shërbejnë vetëm në shtëpi dhe mund të bëjnë edhe

punë tjera profesionale por jo punë shërbyese hoteliere. Siç tregon hulumtimi për barrierat e pjesëmarrjes së femrës në industrinë HT në zonë i realizuar nga Ubo Consulting si pjesë e Projektit SEED në janar 2015, ku ngacmimet në vendin e punës – trajtimi i padrejtë dhe paragjykes nga personeli dhe klientët e ndërmarrjes ku punojnë përbëjnë 14% të e të anketuara femra që kishin një nga arsyet e mos pëlqimit të profesionit shoqëruar edhe me pa punësi, pasiguri dhe lëvizje nga një kompani HT në tjetër.

Për nivelin e pjesëmarrjes dhe gjendjen e punonjësve femra në sektorin bizneseve HT në këtë zonë nuk ka hulumtime të detajuara. Sidoqë të jetë, për ilustrim, në bazë të një hulumtimi realizuar nga kompania konsulente HROD në kuadër të projektit “Mismatch” në dhjetor 2013, në zonën turistike natyrore të Pejës (Rugova dhe Drini i Bardhë) nga 573 të punësuar, në 109 bizneset hoteliere dhe turistike të intervistuar, 102 (18%) ishin femra, ky numër është më i madh tek femrat e vetëpunësuar (biznes vetjak, angazhim tek familjarët, etj, ku femrat duket se ndjehen më komod) nga 75 të vetëpunësuar 26 (35%) prej tyre ishin femra e ky numër vjen e rritet në ndërmarrjet e ndërlidhura me këtë industri si në komunë, muze dhe OJQ ku në 6 institucione të tilla është vërejtur përqindje e njëjtë e meshkujve dhe femrave të punësuar. Sido që të jetë, edhe nga ato pak femra që kanë zgjedhur shkollimin e mesëm profesional HT, gjysma të motivuara si një mundësi punësimi dhe vetëm gjysma e tyre sepse e duan një profesion të tillë i cili duket të jetë i portretizuar tradicionalisht si profesion për meshkuj, siç dhe mund të tregohet nga hulumtimi i janarit 2015.



*Pamje ilustruese nga punëtorja e dytë në Pejë*

**Punëtorja 2** – mbajtur në tetor 2014 në Pejë, Gjakovë dhe Prizren ofroi mundësi që pjesëmarrësit e Këshillave lokale që nën orientimin “dialogu dhe bashkëpunimi në arsimimin për turizëm” në Pejë, Gjakovë dhe Prizren të identifikojnë palët e përfshira/interesuara apo hisedarët kundrejt analizës së gjendjes identifikuar në punëtorinë e parë, si dhe nivelin aktual dhe të dëshirueshëm dhe udhëzimeve për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit në mes shkollave të mesme profesionale HT me bizneset dhe hisedarët tjerë si rrjedhojë ngritjen e cilësisë së arsimimit të mesëm profesional me ndikim në zhvillimin e sektorit HT në zonën e përfshirë. Dedikim të veçantë në këtë punëtori i është kushtuar perceptimit të pjesëmarrësve rreth mundësive të përfshirjes së femrave në profile të ndryshme HT. Në këtë fazë të konsultimeve është krijuar trangu i problemeve dhe nevojave.

**Punëtorja 3** – mbajtur në muajin dhjetor 2014 në Pejë, Gjakovë, Prizren ofroi mundësi që pjesëmarrësit të formulojnë vizionin e përbashkët që thekson nevojën për rritjen e bashkëpunimit mes palëve të interesit/hisedarët si parakusht për trajtimin e çështjeve të identifikuara që kanë të bëjnë me plan programet mësimore, praktikave profesionale të nxënësve dhe mbështetjen e mësuesve në shkollat profesionale për hotelieri turizëm (HT) si dhe pjesëmarrjen e femrës në industrinë e turizmit. Për të bërë të mundur analizimin e rezultateve nga punëtorja e dytë, vizionet janë paraqitur si probleme të transformuar në objektivat vijuese që synojnë përmirësimin e sektorit të turizmit:


1. Krijimi i një sistemi për të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme plan-programet mësimore të shkollës së mesme profesionale - dega hotelieri turizëm (HT) në mënyrë që të garantohet ndërlidhja me nevojat e tregut;

2. Krijimi i një sistemi funksional të praktikave profesionale, përfshirë mbikëqyrjen, për të siguruar që nxënësit e degës HT pajisen me kompetenca dhe shkathtësi praktike të nevojshme.

3. Krijimi i një sistemi këshillimi dhe trajnimi të vazhdueshëm për mësuesit e degës HT lidhur me nevojat dhe mjedisin e biznesit hotelier turistik;

4. Përfshirja e më shumë femrave në sektorin hotelieri turizëm.

Figura: raporti në mes teorisë dhe praktikës në shkolla profesionale sipas strategjisë së MASHT (HROD)



Në këtë fazë të konsultimeve është krijuar trangu i problemeve dhe nevojave. Me këtë rast është bërë referencë tek kompetenca për plan-programet mësimore e rezervuar me ligj të arsimit të mesëm profesional Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ndonëse në proces amandamentimi ku pritet rritja e përfshirjes në planifikim dhe propozimeve për ndryshime – përshtatje të plan-programeve mësimore dega HT me qasje nga poshtë – lartë në masën deri 20% nga ana e vetë shkollave të mesme profesionale me ndihmën e hisedarëve.

Po ashtu, është potencuar strategjia për punë praktike, ku dhe nga pjesëmarrësit e këshillave lokale është kërkuar ndërtimi i një sistemi funksional të praktikave profesionale të nxënësve të shkollave të mesme HT të zonës së përfshirë sipas Strategjisë së MASHT për praktikën profesionale 2013-2020 ku synohet që raporti teori praktikë të balancohet ku koha dedikuar praktikës profesionale progresivisht rritet nga 40% praktikë në vitin e parë të studimit, në 50% viti i dytë deri 60% në vitin e tretë kurse koha e teorisë anasjelltas zvogëlohet eksponencialisht në raport me praktiken.



*Pamje ilustruese nga punëtorja e katërt në Gjakovë*

**Punëtorja 4** - mbajtur në datat 11, 12 dhe 13 Mars 2015 në Pejë, Gjakove, Prizren kishte për qëllim shqyrtimin e rezultateve të punëtorive të kaluara si analiza e palëve të interesit, trugut të problemeve duke përfshirë shkaktarët dhe ndikimi i tyre dhe transformimi dhe konsolidimi në trug të objektivave specifike për arritjen e së cilave u identifikuan intervenime/masa nga anëtarët e Komisioneve lokale pjesëmarrës në punëtori.

Rezultat i punëtorisë së katërt është draft korniza logjike e konsoliduar me 4 objektivat strategjike –tematik, objektivat specifike si dhe intervenimet/masat e propozuara për secilën objektiv specifik. Kjo punëtori është udhëhequr nga konsulenti i angazhuar në kuadër të Programit SEED i cili kontribuoi gjatë kësaj periudhe dhe më pas në hartimin e strategjisë.

## OBJEKTIVAT DHE MASAT

Kjo strategji përbëhet nga 4 objektiva strategjik, ashtu siç janë konceptualizuar dhe miratuar nga Këshillat Komunale ndarazi, më pastaj integruar në këtë dokument të vetëm i cili për çdo objektive përmban në vete një numër (14) objektivash më specifik dhe një sërë masash (52) të parapara për arritjen e atyre objektivave si në vete dhe/apo të ndërlidhura me objektiva apo masa të tjera të paraqitura në të ashtuquajturën korniza logjike e cila i bashkëngjitet këtij dokumenti.



**Krijimi i një sistemi për të përditësuar plan programet e shkollave të mesme profesionale dega hotelieri turizëm (HT) në zonën e përfshirë sipas nevojave të tregut**  
*(4 objektiva specifik, 16 masa);*

**Krijimi i një sistemi efektiv të praktikave profesionale që nxënësit e shkollave të mesme profesionale HT në zonën e përfshirë të pajisen me shkathtësi praktike**  
*(3 objektiva specifik, 12 masa)*



**Krijimi i një sistemi për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të shkollave të mesme profesionale HT në zonën e përfshirë lidhur me nevojat dhe mjedisin e biznesit HT**  
*(3 objektiva specifik, 10 masa);*

**Rritja e numrit të femrave në sektorin hotelieri turizëm në zonën e përfshirë**  
*(4 objektiva Specifik, 14 masa);*

Masat e marra së bashku në të katër fushat tematike të kthyer në objektivat e më sipërme të përgjithshme me objektivat vijuese specifike dhe masat e propozuara përbëjnë një set të gjithëanshëm që Këshillat Komunale (grupet punuese) në komunat Pejë, Gjakovë dhe Prizren i konsiderojnë si të domosdoshme për ndryshimin e gjendjes në kuptimin e ngritjes së bashkëpunimit të hisedarëve në zhvillimin dhe promovimin e arsimimit hotelier dhe turistik në zonën e përfshirë duke përfshi krijimin e një praktike profesionale funksionale, ngritjen e kapacitetit të personelit të këtyre shkollave si dhe ngritjen e pjesëmarrjes së femrave në shkollat dhe industrinë hoteliere turistike në zonë.

Hisedarët e konsiderojnë këtë set masash si udhërrëfyes për zhvillimin afat mesëm dhe afat gjatë të arsimimit profesional dhe industrisë HT në këtë zonë. Andaj, ata aprovuan Strategjinë dhe zotohen për promovimin dhe implementimin e saj.

Në vijim është një shqyrtim i shkurtër i pritjeve nga realizimi i strategjisë, shoqëruar me masat e parapara për secilën objektive të lartshënuar dhe ato specifike si dhe një listë referencash trajtuar në dokument.

Strategjia për rritjen e bashkëpunimit mes shkollave të mesme ekonomike drejtimi i turizmit dhe hotelierisë dhe bizneseve të këtij sektori pritet të ndikoj që ky bashkëpunim të kontribuoj në krijimin e mundësive që nxënësit të kenë mundësi të përfundojnë praktikën në ndërmarrje, pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në përpilimin e plan programeve duke u bazuar në nevojat e tregut, mbështetjen e personelit të shkollave si dhe krijimin e mundësive për inkuadrim të më shumë femrave në këtë sektor.

Strategjia thërret për pjesëmarrje më të madhe e ndërmarrjeve nga sektori i hotelierisë dhe turizmit në përgatitjen e kuadrove kompetent sipas nevojave të tregut. Duke mundësuar që nxënësit që ndjekin këtë drejtim të kryejnë praktikën nëpër ndërmarrje.

Parashihet pjesëmarrja e personelit të shkollave ekonomike profesionale të komunës së Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës, që të krijojnë vegla që të inkuadrojnë bizneset në përpilimin e plan programit dhe përfshirjen e ndërmarrjeve në reformimin e drejtimit të hotelierisë dhe turizmit.

Parasheh pjesëmarrjen dhe angazhimin e të gjithë hisedarëve të sektorit që të angazhojnë më shumë femra si ne edukim ashtu edhe në punësimin e tyre në këtë sektor.

Duke u bazuar në “Strategjinë e praktikave profesionale 2013-2020” të përpiluar nga MASHT, Korniza e re e Kurikulumit (plan programit) të Kosovës, programet e praktikës profesionale janë pjesë e kurikulumit të shkollave të mesme profesionale”. Si dhe thekson që këto programe iu mundësojnë nxënësve të kalojnë një periudhë të planifikuar kohore nëpër ndërmarrje, që të krijojnë përvojë pune.

Pjesëmarrja e ndërmarrjeve nga sektori i turizmit dhe hotelierisë është thelbësore në aftësimin e kuadrove për nevojat e tregut, si dhe në reformimin e shkollimit profesional drejtimi hotelieri turizëm. Andaj strategjia thërret dhe inkurajon dhe orienton këtë proces përmes realizimit të masave propozuar.

Strategjia është në funksion dhe e ndërlidhur me strategji tjera sektoriale dhe ndër-sektoriale në të tre komunat dhe zonën e përfshirë në projekt si dhe në ato fqinje të cilat palët e interesuara mund të kontribuojnë dhe përfitojnë respektivisht duke realizuar çfarëdo pjese të kësaj strategjie. Dokumenti i Strategjisë do të prezantohet në një konferencë me pjesëmarrje të gjerë të palëve të interesit si dhe do të publikohet në Ueb faqen e bartësit të këtij procesi OJQ Syri i Vizionit dhe të tjera dhe do të promovohet e inkurajohet gjithë palët e interesuara, përfshi donatorët që ta përdorin e zgjerohen në punën planifikuese dhe realizuese në tematikën arsimimi profesional dhe sektori Hotelieri Turizëm në këtë zonë e më gjerë.

Për realizimin e kësaj strategjie, në kuadër të programit SEED në Kosovë është bërë një thirrje për grante në bazë të aplikimeve të palëve të interesuara me koncepte dhe projekte që synojnë përmirësimin e gjendjes ndërlidhur me ndonjë apo më tepër objektiva të kësaj strategjie. Thirrja është publikuar në internet dhe media duke u fokusuar në tre aspekte, plan-programet, praktikën dhe rritjen e femrës në SHME dega HT dhe industrinë HT, duke lënë hapësirë edhe për trajtimin e objektivit që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve për personelin e shkollave përmes trajnimeve, këshillimit, etj. Objektivat dhe kriteret e përzgjedhjes për grante janë përcaktuar dhe miratuar nga sponsori i strategjisë së bashku me Këshillat Komunale.

Në vijim është përmbajtja e 4 objektivave të përgjithshëm me 14 objektivat specifik dhe 52 masat e parapara për arritjen e atyre objektivave si të vetme dhe/apo të ndërlidhura me objektiva apo masa të tjera të paraqitura në të ashtuquajturën “korniza logjike” e Strategjisë.

Ligji Nr. 04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë (MASHT, 28 shkurt 2013)

Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë 2013-2020 (MASHT, 22.11.2013)

Ligji Nr. 04/L-176 për Turizmin (MTI, 29.04.2013)

Strategjitë për zhvillimin rajonal ekonomik të rajonit jugor dhe perëndimor 2010 – 2013 dhe strategjitë sektoriale të turizmit që derivojnë nga to (RDA – Jug, RDA Perëndim)

Strategjia rajonale për turizëm të qëndrueshëm në rajonin perëndimor të Kosovës (HROD për RDA-Perëndim, 2013)

Strategjia për zhvillimin ekonomik në Komunën e Pejës 2013 – 2017 (HROD për Komunën, Korrik 2013)

Hulumtimi i nevojave dhe mundësive të sektorit hotelieri turizëm për Praktikat Profesionale të nxënësve të degës Hotelieri Turizëm të SHME “Ali Hadri” në Pejë, Raport, HROD për OJQ Syri i Vizionit në kuadër të projektit Mismatch, Dhjetor 2013);

Hulumtimi për barrierat gjinore që lidhen me pjesëmarrjen e femrave në edukim e punësim në sektorin e turizmit në Kosovë, Raport, Ubo Consulting - Syri i Vizionit në kuadër të projektit SEED, (Janar 2015)

[https://www.facebook.com/SHMEAli-HadriPej%C3%AB-164686813689808/info/?tab=page\\_info](https://www.facebook.com/SHMEAli-HadriPej%C3%AB-164686813689808/info/?tab=page_info) (tetor 2015)

<https://www.facebook.com/kadrikusari123/?fref=ts> (tetor 2015)

<https://www.facebook.com/Prizren.Sh.M.L.YmerPrizreni> (tetor 2015)

Informata e shkurtë prezantuese e SHME Pejë, Gjakovë dhe Prizren nga personeli i këtyre shkollave



## KORNIZA LOGJIKE

### Objektivi i përgjithshëm 1:

*Krijimi i një sistemi për të përditësuar plan programet e shkollave të mesme profesionale – dega hotelieri turizëm (HT) në zonën e përfshirë sipas nevojave të tregut*

Objektivat specifike	Masat
<p>1.1</p> <p>Rritja e bashkëpunimit, pjesëmarrjes dhe koordinimit në mes shkollave HT në zonën e përfshirë dhe hisedarëve tjerë kyç, duke përfshirë bizneset HT lidhur me promovimin e plan-programeve të degës HT si dhe për të trajtuar çështje të ndërlidhur me të, shkëmbyer njohuri, eksperiencë dhe iniciativa të përbashkëta.</p>	<p>1.1.1</p> <p>Te forcohet ndërlidhja në mes shkollave të mesme HT në zonën e përfshirë dhe hisedarëve tjerë përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• informimit, përfshirjes së vazhdueshme, takimeve periodike, shkëmbimeve të informacionit, njohurive dhe praktikave të mira, dhe</li> <li>• ndërmarrja e veprimeve të nevojshme të koordinuara të cilat mund të bëhen në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit me mekanizma implementues</li> </ul> <p>1.1.2</p> <p>Harmonizimi i plan programeve dhe shkëmbimi i praktikave të mira në mes shkollave të mesme HT në zonën e përfshirë si dhe në mes tyre dhe shkollës universitare dega e studimit HT në Pejë.</p> <p>1.1.3</p> <p>Rrjetëzimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira në mes shkollave HT në zonën e përfshirë dhe me shkolla të ngjashme jashtë vendi si p.sh. në Shqipëri, Slloveni, Austri, etj. pjesëmarrja e shkollave të mesme HT në "Bordin Industrial" me funksion hulumtues dhe këshillues të Universitetit "Haxhi Zeka", etj.</p> <p>1.1.4</p> <p>Shkëmbimi i mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave HT brenda dhe jashtë vendit përmes aktiviteteve të ndryshme si shkolla verore, kampingjeve, pranisë së nxënësve dhe mësuesve mysafirë nga një shkollë në tjetër për një aktivitet të shkurtë shkëmbimi, konferencier, etj. apo edhe më të gjatë si semestral etj.</p>

	<p>1.1.5</p> <p>Krijimi i një baze të dhënash si platformë komunikimi dhe shkëmbimesh në mes palëve të interesit në veçanti shkollës dhe bizneseve e përdorshme edhe për tematiken “praktika profesionale” dhe punësim të nxënësve HT.</p> <p>1.1.6</p> <p>Përfshirja e shkollave të mesme HT si palë aktive në planifikime zhvillimore të industrisë HT lokale/rajonale.</p>
<p>1.2</p> <p>Ndërmarrja e iniciativave për ndryshim me qasjen nga “poshtë – lartë dhe anasjelltas në përditësim dhe harmonizimin e plan-programeve të shkollave të mesme dega HT në zonën e përfshirë sipas nevojave të tregut</p>	<p>1.2.1</p> <p>Ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i mekanizmave të nevojshëm në shkollat e mesme dega HT në zonën e përfshirë për hulumtim tregu dhe përshtatja e plan-programit kërkesave dhe trendit të zhvillimit të industrisë HT sipas rezultateve nga hulumtimet dhe të dhënave tjera.</p> <p>1.2.2</p> <p>Propozimi dhe avokimi tek institucionet vendimmarrëse arsimore për zgjerimin e profileve apo shtimin e moduleve/lëndëve profesionale në plan-programin e shkollës së mesme HT në zonën e përfshirë, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• profile/lëndë profesionale për udhëzues turistik malor/bjeshkatari, kulturor, sportesh ekstreme, animatorë sporti, rekreacioni, kulture, kërkim shpëtim; <i>si dhe asistent* restoranti, kuzhine dhe hotelier</i>. në funksion të zgjerimit të ofertës dhe shërbimeve turistike duke iu referuar praktikave të mira me turizëm të zhvilluar,</li> <li>• lëndëve ndër-sektoriale si komunikim, anglisht, marketing, ndërmarrësi, si dhe njohuri për burimet dhe vlerat natyrore dhe kulturore turistike lokale dhe rajonale si dhe njohuri rreth zhvillimeve të sektorit HT lokal dhe më gjerë.</li> </ul> <p>1.2.3</p> <p>Krijimi i një sistemi certifikues për njohuri dhe shkathtësi multi-diciplinare të nevojshme në HT përmes trajnimeve dhe vizitave studimore të ofruara nga shkollat e mesme HT të zonës së përfshirë dhe/apo ndonjë organizate tjetër për individë/grupe të interesuara duke iu përshtatur nevojave të sektorit HT.</p> <p>1.2.4</p> <p>Përfshirja e “ligjëruesve të ftuar” nga biznesi HT në procesin mësimor si mënyrë e ndërlidhjes së teorisë me praktiken dhe zhvillimet në sektorin HT.</p> <p>1.2.5</p>

	<p>Shkëmbimi komplementar i plan-programeve, personelit dhe eksperiencave në mes shkollave HT në zonën e përfshirë (pasi këto shkolla ndrzshojn në profile dhe nivele të ndryshme zhvillimi) si dhe shkëmbime me shkolla HT jashtë vendi.</p> <p><i>Shënim*profilet e reja shënuar me shenjën * karakteristike vetëm për shkollën e mesme dega HT Gjakovë.</i></p>
<p><b>1.3</b></p> <p><b>Ngritja e kapaciteteve njerëzore, materiale dhe financiare të shkollave së mesme HT, si dhe kapacitetet njerëzore të bizneseve dhe institucioneve të sektorit HT</b></p>	<p><b>1.3.1</b></p> <p>Ngritja e kapaciteteve njerëzore të personelit menaxhues dhe akademik të shkollave HT në zonën e përfshirë, përmes trajtimeve, këshillimit dhe asistencës tjetër teknike, për hartimin e projekteve inovative kërkimore si dhe aplikimi për fonde tek institucionet/donatorët.</p> <p><b>1.3.2</b></p> <p>Sigurimi i buxhetit të nevojshëm dhe pajisjeve për konkretizim (laboratorë mësimor, pajisje dhe lëndë shpenzuese në shkollat HT në zonën e përfshirë) nga institucionet përgjegjëse DKA/MASHT, donatorët, bizneset, kontributet në natyrë apo monetar nga prindërit, shërbime fitimprurëse të shkollës, etj.</p> <p><b>1.3.3</b></p> <p>Motivimi dhe ofrimi i asistencës teknike për nxënësit e interesuar gjatë dhe pas shkollimit për krijim biznesesh të reja HT, qasje në grante dhe mentorim ku përfshirja e lëndës së ndërmarrësisë do të shërbente si pikënisje.</p> <p><b>1.3.4</b></p> <p>Përfshirja e qendrës së punësimit për ngritje kapacitetesh teknike të nevojshme për rritjen e punësueshmërisë dhe referime kuadrosh sipas nevojave dhe kërkesave të bizneseve dhe ofrimi i informatave (feedback) shkollave në zonën e përfshirë për nevojat e tregut për profilet HT të kërkuara.</p> <p><b>1.3.5</b></p> <p>Plotësimi i kuadrove deficitare për lëndë profesionale në shkollat e mesme HT në zonën e përfshirë dhe avancimi i personelit aktual me metodat e reja të mësimdhënies teorike e praktike.</p> <p><b>1.3.6</b></p> <p>Ngritja e kapaciteteve në sektorin privat HT në zonën e përfshirë ashtu që të ketë mundësi të pres dhe kontribuoj në praktikën profesionale të nxënësve të shkollave të mesme HT të kësaj zone.</p>

	<p><b>1.3.7</b></p> <p>Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe avancimi institucional i sektorit të turizmit në drejtori turizmi në nivel komunal me burime të nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare po ashtu në nivelin qendror.</p> <p><b>1.3.8</b></p> <p>Realizimi i vizitave studimore dhe bartja e praktikave të mira nga plan-programet (teori dhe praktikë) të personelit menaxhues dhe akademik të shkollave të mesme dhe bizneseve HT në rajon, e më gjerë;</p> <p><b>1.3.9</b></p> <p>Sigurimi i teksteve dhe pajisjeve profesionale për shkollat HT në zonën e përfshirë dhe bashkëpunimi i tyre me biznese dhe organizata tjera HT qeveritare (zyra për turizëm, etj) dhe jo qeveritare (OJQ me aktivitet turistik etj.) dhe përdorimi i materialeve të ndryshme të tyre si material shtesë arsimor.</p>
--	---

## Objektivi i përgjithshëm 2:

*Krijimi i një sistemi efektiv të praktikave profesionale që nxënësit e shkollave të mesme profesionale - drejtimi HT në zonën e përfshirë të pajisen me shkathtësi praktike*

Objektivat specifike	Masat
<p>2.1</p> <p>Ngritja bashkëpunimit dhe koordinimit në mes shkollave të mesme HT dhe biznese në këtë sektor si dhe palëve e tjera të interesit për realizimin efektiv të praktikave profesionale në shkollë dhe në ndërmarrje në zonën e përfshirë.</p>	<p>2.1.1</p> <p>Vetëdijësimi i ndërmarrjeve HT në zonën e përfshirë për rolin e tyre në praktikën profesionale të nxënësve të shkollave të mesme HT të zonës duke stimuluar rritjen e përgjegjësisë sociale të këtyre bizneseve si dhe përfitimet e dyanshme si sigurimi i kuadrove të kualifikuara për bizneset, angazhimi pa pagesë i praktikantëve gjatë praktikës derisa ata mësojnë duke shërbyer dhe përfitime tjera të shumanshme;</p> <p>2.1.2</p> <p>Ndërmarrja e një fushate vetëdijësuese dhe ofrimi i asistencës teknike për rritjen e interesimit, komunikimit dhe iniciativave të përbashkëta nga palët e interesit për kryerjen e praktikës profesionale të shprehur përmes një memorandum bashkëpunimi në mes palëve (shkollë-DKA-biznese HT, etj.) të shoqëruar me takime pune periodike dhe dokumente teknike si kontrata, doracak i përgjegjësive dhe detyrimeve në realizimin e praktikës duke përfshi mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit.</p> <p>2.1.3</p> <p>Hartimi i dokumente teknike si doracak praktike profesionale (përfshi doracakun ekzistues hartuar nga shkolla dhe një OJQ) me udhëzime dhe formularë të përdorshëm për palët si format kontratë në mes praktikantit/es dhe ndërmarrjes pritëse HT, formularë monitorimi, vlerësimi, si dhe përcaktimi i të drejtave dhe përgjegjësive të palëve të përfshira.</p> <p>2.1.4</p> <p>Organizimi dhe pjesëmarrja në panairë të bizneseve dhe produkteve lokale/rajonale me material informues dhe vetëdijësimi i opinionit të gjerë lidhur me shkollat e mesme HT, profilet dhe mundësitë e karrierës;</p> <p>2.1.5</p> <p>Këmbimi i përvojave në mes palëve të interesit, vendeve dhe institucioneve HT me përvojë dhe infrastrukturë që plotësojnë kushtet e zbatimit të teorisë në praktikë profesionale.</p>

<p>2.2</p> <p>Përditësimi dhe harmonizimi i plan-programeve mësimore sipas nevojave të tregut dhe standardeve arsimore lidhur me praktikat profesionale të nxënësve në shkollat e mesme HT në zonën e përfshirë.</p>	<p>2.2.1</p> <p>*Realizimi koherent, kualitativ dhe pa shkëputje kohore i praktikave profesionale në ndërmarrje HT për profile ekzistuese dhe të reja propozuar (subjekt aprovimi nga shkolla dhe institucionet) si: udhëzues turistik malor, kulturor, sportesh ekstreme, animatorë sporti, rekreacioni, kulture, etj. bjeshkatari, kërkim shpëtim, etj. në funksion të zhvillimit të turizmit.</p> <p>2.2.2</p> <p>Realizimi i praktikave profesionale sipas strategjisë aktuale të MASHT për punë praktike të shkollave mesme profesionale nga 40% në vitin e parë në 60% kohë pune praktike në vitin e tretë të studimit.</p> <p><i>Shënim *: konsiderohet e nevojshme që praktikat profesionale të planifikohen dhe koordinohen me kohë, të realizohen pa shkëputje, pra në blloqe kohore (totali i orëve praktike në një periudhë e ngjashëm por jo disa orë apo një ditë në javë) në ndërmarrje HT duke iu përshtatur kërkesave dhe nevojave të bizneseve për profile praktikantësh si dhe për periudhën e përshtatshme për bizneset për realizimin e praktikës që përkon edhe me volumin/stinën kur rritet numri klientëve të tyre dhe respektivisht rritet ekspozimi i praktikantëve ndaj punëve dhe proceseve prodhuese/ shërbyese HT duke kontribuar në rritjen e kualitetit të praktikës.</i></p>
<p>2.3</p> <p>Sigurimi i burimeve njerëzore, materiale dhe financiare adekuate në shkollat dhe bizneset HT të zonës së përfshirë sipas nevojave të tregut.</p>	<p>2.3.1: Krijimi i infrastrukturës në shkollat e mesme HT si kabinete gatimi, shërbimi dhe funksione tjera te parapara në plan-programin (ekzistues dhe atë që do të mund pasurohet me profile të reja), sigurimi i buxhetit dhe mjeteve shpenzuese të nevojshme dhe koordinimi në mes i palëve për të realizuar praktika profesionale.</p> <p>2.3.2: Tërheqja e kuadrove të kualifikuara përmes promovimit dhe aplikimit të praktikave të mira të punësimit “fer” dhe konkurrues si dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore të personelit të shkollës dhe bizneseve HT në mënyrë të vazhdueshme sipas parimit “të mësuarit gjatë gjithë jetës” në raport me nevojat e tyre dhe trendin e industrisë HT.</p> <p>2.3.3: Motivimi dhe stimulimi i ndërmarrjeve HT me mjete monetare dhe jo monetare për të lehtësuar angazhimin e praktikantëve të shkollës së mesme dega HT përfshi mbulimin e plotë/pjesshëm të shpenzimeve të praktikantëve si udhëtim sidomos në zonat rurale, pagesë simbolike/bursë për kohën e shërbimit, etj.</p> <p>2.3.4: Ngritja e kapaciteteve njerëzore në shkollën HT dhe ndërmarrjet HT për angazhimin e suksesshëm të praktikantëve përmes këshillimit dhe asistencës teknikë;</p> <p>2.3.5: Sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare për realizimin kualitativ të praktikës profesionale në shkollat e mesme HT në zonën e përfshirë (shpenzime operacionale, material shpenzues, et.).</p>

### Objektivi i përgjithshëm 3:

*Krijimi i një sistemi për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të shkollave të mesme profesionale - drejtimi HT në zonën e përfshirë lidhur me nevojat dhe mjedisin e biznesit hotelier turistik*

Objektivat specifike	Masat
<p>3.1</p> <p>Hartimi i politikave për aftësimin e kuadrit arsimor sipas parimit “të mësuarit gjatë gjithë jetës” në shkollat e mesme dega HT në zonën e përfshirë</p>	<p>3.1.1</p> <p>Hartimi i një strategjie dhe plani veprimi në mes palëve të interesit për ngritjen e kapaciteteve dhe këshillim personelit të shkollave dega HT në bazë të principit “të mësuarit gjatë gjithë jetës” përmes këtyre hapave:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Identifikimi i nevojave për këshillim dhe trajnime të mësuesve në shkollat e mesme dega HT dhe paraqitja e nevojave tek DKA/MASHT për aprovim dhe sigurim buxheti përfshi aplikim për fonde alternative apo komplementare tek donatorët;</li><li>- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme si trajnime, seminare, seanca këshillimore, shkëmbime, etj. nga shkollat HT dhe/apo në bashkëpunim me palët e interesit.</li><li>- Këmbimi i përvojave dhe krijimi partneriteti me institucionet si shkolla HT në vendet përkatëse në raport me traditën dhe llojin e turizmit p.sh. turizmi malor vs bregdetar, kulturor vs natyror, etj.</li></ul> <p>3.1.2</p> <p>Ngritja profesionale e mësuesve të shkollave HT për aplikimin e ndryshimeve të plan programeve të praktikës dhe përdorimit të literaturës, laboratorëve dhe pajisjeve bashkëkohore dhe trendët e zhvillimit të industrisë HT.</p> <p>3.1.3</p> <p>Vlerësimi periodik i kërkesave dhe nevojave të mësimdhënësve të shkollës dega HT dhe paraqitja e tyre tek DKA dhe donatorët për plotësim përmes trajnimeve dhe këshillimeve të nevojshme.</p> <p>3.1.4</p> <p>Organizimi i takimeve periodike në mes shkollës së mesme – mësimdhënësve dega HT dhe DKA dhe trajtimi i nevojave dhe kërkesave</p>

<p>3.2</p> <p>Ngritja e kapaciteteve të personelit të shkollave dega HT në zonën e përfshirë për hartim projektesh dhe ngritje fondesh</p>	<p>3.2.1</p> <p>Organizimi i trajnimeve për personelin e shkollës dega HT për hartim projektesh dhe ngritje fondesh tek institucionet, donatorët dhe mundësi tjera kreative, etj.</p> <p>3.2.2</p> <p>Organizimi i trajnimeve dhe ofrimi i asistencës teknike për personelin e shkollave profesionale HT, në zonën e përfshirë, për përgatitjen dhe realizimin e projekteve kërkimore (pyetësor/intervista lidhur kënaqshmërinë me nivelin e shërbimeve të këtyre shkollave, nevojat e bizneseve HT, etj), si dhe analizimin e rezultateve dhe adaptimin e plan-programeve dhe praktikave kërkesave të tregut sipas rezultateve kërkimore.</p>
<p>3.3</p> <p>Ndërmarrja e iniciativave nga grupet e interesit për mbështetje mësuesve HT</p>	<p>3.3.1</p> <p>Organizimi i trajnimeve/seminareve për mësimdhënësit e degës HT nga ekspert të bizneseve HT lokale/rajoni/huaj.</p> <p>3.3.2</p> <p>Organizimi vetë, pjesëmarrja dhe mbështetja nga hisedarët e sektorit HT në trajnime dhe forma tjera në bazë të analizave të nevojave për ngritje kapacitetesh njerëzore në dhe jashtë vendi.</p> <p>3.3.3</p> <p>Organizimi, pjesëmarrja e gjithë hisedarëve të HT dhe mbështetja e shkëmbimeve të eksperiencave me vende përkatëse në rajon dhe më gjerë sipas llojeve të turizmit si malor, kulturor-historik, etj.</p> <p>3.3.4</p> <p>Sigurimi i mjeteve financiare dhe tjera përmes donacioneve nga shkollat HT si dhe në bashkëpunimi me OJQ, bizneset, institucionet.</p>



## Objektivi i përgjithshëm 4:

### Rritja e numrit të femrave në sektorin *hotelieri turizëm* në zonën e përfshirë

Objektivat specifike	Masat
4.1 Rritja e vetëdijes së komunitetit për mundësitë, rolin dhe nevojën e përfshirjes dhe rritjes së numrit të femrave në shkollat e mesme dhe industrinë HT.	<p>4.1.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese multi-mediatike (shkollë, tv/radio, biznese, etj.) dhe prezantime në kl-9 në zonën urbane dhe rurale (veçanërisht) për rolin e femrës dhe mundësinë e karrierës në HT, si shkollimi i mesëm dhe i lartë me mundësi punësimi/vetëpunësimi të shpejtë dhe sigurt në industrinë HT e cila është në rritje bazuar në praktika të mira nga vende me HT të zhvilluar duke mënjanuar stereotipet e ndërlidhura në të kaluarën me veprimtarinë HT.</p> <p>4.1.2 Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse, veçanërisht për rritjen e numrit dhe rolit të femrës në sektorin HT (shkollë, biznese, institucione, etj.) dhe një strategjie/plani veprimi në mes palëve të interesit në sektor.</p> <p>4.1.3 Pjesëmarrje aktive e femrës në shoqata ekzistuese/që do të mund krijohen dhe promovimi i pjesëmarrjes së femrave në industrinë HT.</p> <p>4.1.4 Krijimi i partneriteteve formale dhe/apo jo formale në mes palëve të interesit për të siguruar rritjen e përfshirjes së femrave në industrinë HT, p.sh. zyra komunale për barazi gjinore me shkollën, bizneset dhe organizata tjera HT.</p> <p>4.1.5 Inicimi i takimeve të palëve të interesit për të trajtuar problematikat përfshi përfshirjen e femrës në shkollat dhe industrinë HT në zonën e përfshirë.</p> <p>4.1.6 Sigurimi i fondeve për realizimin e fushatave vetëdijësuese për përfshirjen e femrës në shkollat dhe industrinë HT nga institucionet përkatëse dhe donatorët dhe bizneset e interesuara.</p>

<p>4.2</p> <p>Krijimi i kuadrove sipas kërkesës së tregut duke rritur numrin e femrave në sektorin HT.</p>	<p>4.2.1</p> <p>Krijimi i një programi specifik nga palët e interesit për ngritjen profesionale të femrave, veçanërisht në zonat rurale dhe të pa zhvilluara por me potencial turistik, për të punuar në sektorin HT në përputhje me trendin e tregut HT.</p> <p>4.2.2</p> <p>Realizimi i vizita studimore me qëllim këmbimi eksperiencash profesionale në vendet me turizëm të zhvilluar, duke trajtuar përveç tjerash përfshirjen e femrës në HT dhe adoptimi i përvojave të mira.</p> <p>4.2.3</p> <p>Trajnimi/rorientimi sipas nevojës për ish-punonjëset hotelier turistike femra që në të kaluarën kanë punuar në sektorin HT në zonën rurale dhe urbane mund të kenë lënë ushtrimin e kësaj veprimtarie për shkak të rrethanave si mbyllja e ndërmarrjeve shoqërore HT, mungesa e vizitorëve, etj. dhe rikthimi i tyre në industri.</p>
<p>4.3</p> <p>Sensibilizimi dhe inkurajimi i prindërve për mbështetje të vendimeve të vajzave për karrierë përfshi studime në shkollën e mesme HT.</p>	<p>4.3.1</p> <p>Organizimi i “ditëve të vajzave” në profesione të ndryshme si për shembullin e organizimit nga GIZ, etj. ku paraqiten profesionet e ndryshme dhe përfshirja e femrave në to gjithashtu edhe në HT.</p> <p>4.3.2</p> <p>Promovimi dhe stimulimi i vetëvendosjes së femrës për karrierë arsimimi dhe pune në sektorin HT.</p>
<p>4.4</p> <p>Inkurajimi i shkollave dhe bizneseve HT për barazi gjinore</p>	<p>4.4.1</p> <p>Inicimi i hartimit të politikave qeveritare për promovimin dhe punësimin e femrës, si aplikimi i një kuote minimale punësimi të femrave të kualifikuara në ndërmarrjet publike dhe private, etj.</p> <p>4.4.2</p> <p>Organizimi i debateve me palët e interesuara për tematikën rritja e femrave në industrinë HT.</p> <p>4.4.3</p> <p>Rritja e numrit dhe trajtimi “fer” i femrave në shkollat dhe bizneset HT në zonën e përfshirë.</p>